



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:024375
Datë: 26.06.2018
Numri i dokumentit: 00077090

P.nr.2168/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Vjollca Buzhala me bashkëpunëtorin profesional Shyqri Hoxha, në lëndën penale kundër të akuzuarit Sh. Q., nga Prizreni, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në vazhdim KPRK), sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore në Prizren – PP/IL.nr.1926-7/2017, të datës 21.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Atnor Skoro, të akuzuarit, me datë 26.06.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

SH. Q., nga i ati Y. dhe e ëma S., e lindur K., i lindur më *data e lindjes...*, në Prizren me vendbanim tek banesat e dëshmorëve ..., nr..., me profesion punëtor, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 31.03.2017, rreth orës 11:30 min, në Prizren, në rrugën ..., nr..., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, me përdorimin e forcës, merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit J. Sh., në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari kishte lidhur me zingjir biçikletën e markës “Polar Trinty”, me ngjyrë të zezë, në korridorin e banesës i pandehuri e shfrytëzon momentin e volitshëm, mos prezencën e të dëmtuarit, ku me mjet të përshtatshëm duke përdorur pinca (dana për prerjen e metalit), merr biçikletën në vlerë prej 160 euro dhe largohet nga vendi i ngjarjes.

-Kësodore ka kryer veprën penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 parag.1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata në bazë të neneve 6, 7, 41, 45, 46, 73, 74 dhe 75 par.1 pika 1.3, dhe nenin 327 parag. 1 të KPK-së lidhur me dhe nenin 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në vazhdim KPPRK), të akuzuarin e gjykon me:

DENIM ME GJOBË

Në lartësinë prej prej **150 /njëqindë e pesëdhjetë/ Euro**, të cilin dënim i akuzuara është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë atëherë gjykata dënimin me gjobë do të ia zëvendësoi me dënim me burgim ashtu që një ditë burgim do ti llogaritet me 20 Euro gjobë, respektivisht 7 (shtatë) ditë burgim.

DËNIM ME BURG

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim do ta vuaj pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari J. Sh. nga Prizreni, rruga ..., nr..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari Sh. Q., obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 euro dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 30 euro, që të gjitha në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria e Shtetit në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1926-7/2017, të datës 21.11.2017, kundër të akuzuarit Sh. Q. nga Prizreni, për shkak të veprës penale të vjedhjes së rëndë nga neni 327 paragrafi 1 të KPK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar i akuzuari Sh. Q. e ka pranuar fajsinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas dispozitivit të aktakuzës, dhe ka theksuar se, kërkojë nga gjykata të më shqiptojë një dënim më të butë, ndihet tejet i penduar për veprimin e bërë dhe gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla e as të ngjashme penale.

Prokurori i shtetit nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë, nga se ka konsideruar se e njëjta është bërë në baza vullnetare, ku i akuzuari paraprakisht është udhëzuar nga gjyqtarja gjykuese për pasojat e pranimit të fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPK-së, gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë, i cili pranim është bërë konform nenit 248 në lidhje me nenin 233 par. 18 të KPP, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materijale të rastit konkret dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 par.2. të KPP, gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet qenësore të veprës penale të vjedhjes nga neni 325 par.1 të KPK-së, pasi që me datë 31.03.2017, rreth orës 11:30 min, në Prizren, në rrugën ..., nr..., me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, me përdorimin e

forcës, merr pasurinë e luajtshme të dëmtuarit J. Sh., në atë mënyrë që deri sa i dëmtuari kishte lidhur me zingjir biçikletën e markës “Polar Trinity”, me ngjyrë të zezë, në korridorin e banesës i pandehuri e shfrytëzon momentin e volitshëm, mos prezencën e të dëmtuarit, ku me mjet të përshtatshëm duke përdorur pinca (dana për prerjen e metalit), merr biçikletën në vlerë prej 160 euro dhe largohet nga vendi i ngjarjes.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin konformë nenit 41 të KP, përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në të njëjtën duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në zbutjen apo rritjen e dënimit, shkallën e përgjegjësisë, motivet nga të cilat është kryer vepra penale, prej rrethanave lehtësuese morri parasysh faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, ka qenë korrekt në gjykim, është pënuar për veprën e kryer, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëris veprën e njëjtë penale. Ndërsa prej rrethanave rënduese motivin e kryerjes se veprës penale, peshën e veprës së kryer penale, i akuzuari është i njohur si recidivist i kryerjes së veprave penale, andaj është mendimi i gjykatës që dënimi i shqiptuar do ta arrijë qëllimin e vet konformë nenit 41 të KP, se dënimi i shqiptuar është në harmoni me intenzitetin e dëmtimit të vlerës së mbrojtur, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se do të mundësoj një balans të drejtë në mes të kërkesave që të akuzuarës ti mundësohet risocializimi dhe kërkesës së shoqërisë që ai dënim me peshën e tij të ketë karakter të përgjithshëm parandalues nga kryerja e veprave penale, të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit të respektimit të ligjit. Gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar të akuzuarës është në shërbim të preventivës së përgjithshme, posaçërisht të asaj të posaçme, se do të ndikoj në forcimin e moralit të shoqërisë, përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe është në pajtueshmëri me kërkesat për siguri personale të popullatës së kësaj treve dhe se me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit në të gjitha segmentet e saj.

Vendimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit, është marrë konform nenit 450 dhe 453 të KPPRK-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**

2018:024375, 26.06.2018

G j y q t a r i

Vjollca Buzhala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.